



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
***Qeveria - Vlada - Government***  
***Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice***  
Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Služba Kosova/Kosovo Correctional Service  
*Drejtoria Përgjithshme*

---

## **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

### **Raport Vjetor i Punës**



## Përmbajtja

Fjala hyrëse nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues

<b>I.</b>	<b>PJESA E PARË</b>	
	Misioni, vizioni .....	5
<b>II.</b>	<b>PJESA E DYTË</b>	
	Transparenca, Komunikimi me Publikun .....	6-13
<b>III.</b>	<b>PJESA E TRETË</b>	
	Çështjet Ligjore.....	14-16
<b>IV.</b>	<b>PJESA E KATËRT</b>	
	Siguria, operativa.....	17-28
<b>V.</b>	<b>PJESA E PESTË</b>	
	Inteligjenca .....	29-31
<b>VI.</b>	<b>PJESA E GJASHTË</b>	
	Trajtimi i të burgosurve .....	32-34
<b>VII.</b>	<b>PJESA E SHTATË</b>	
	Vlerësimi dhe klasifikimi i të burgosurve.....	35
<b>VIII.</b>	<b>PJESA E TETË</b>	
	Financat.....	36
<b>IX.</b>	<b>PJESA E NËNTË</b>	
	Inxhinieringu .....	37-40
<b>X.</b>	<b>PJESA E DHJETË</b>	
	Teknologji Informative .....	41
<b>XI.</b>	<b>PJESA E NJËMBËDHJETË</b>	
	Monitorimi i kontratave.....	42-44
<b>XII.</b>	<b>PJESA E DYMBËDHJETË</b>	
	Trajnimet .....	45-46
<b>XIII.</b>	<b>PJESA E TREMBËDHJETË</b>	
	Njësia ekonomike .....	47-48
<b>XIV.</b>	<b>PJESA E KATËRMBËDHJETË</b>	
	Prokurimi publik .....	49
<b>XV.</b>	<b>PJESA E PESËMBËDHJETË</b>	
	Burimet njerëzore.....	50

## **Lista e Shkurtesave**

SHKK - Shërbimi Korrektues i Kosovës

IK – Institucionet Korrektuese

QK - Qendrat Korrektuese

QP - Qendrat e Paraburgimit

BSL - Burgu i Sigurisë së Lartë

QKFL - Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan

QKEKML - Qendra Korrektuese Edukuese Korrektuese për të Mitur në Lipjan

NJPB - Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve

NJVKB - Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve

QAP - Qendra për Aftësim Profesional

APRK - Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës

NJIK – Njësia e Inteligjencës Korrektuese

ICPA - Organizata Ndërkombëtare e Burgjeve dhe Shërbimeve Korrektuese



## Fjala Hyrëse nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës



**Ismail Dibrani**

*Kam nderin dhe kënaqësinë, që në kuadër të transparencës me publikun, të paraqes raportin vjetor të punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës për vitin 2025.*

*Në këtë raport jepen të dhëna të detajuara mbi aktivitetet dhe veprimtaritë e punës një (1) vjeçare të Shërbimit Korrektues të Kosovës.*

*Të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë angazhimin tonë maksimal në përmbushjen e detyrimeve si dhe identifikimin e fushave të caktuara ku nevojitet rritja e kapaciteteve tona me qëllim të ngritjes së performancës së punonjësve të SHKK-së.*

*Gjatë vitit 2025 SHKK ka qenë e përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përmes trajnimeve të ndryshme profesionale, vizitave studimore, seminareve, punëtorive etj. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore në këtë periudhë SHKK-ja ka rekrutuar 113 zyrtar korrektues dhe është në proces të rekrutimit edhe për 100 zyrtarë korrektues.*

*SHKK përmes aktiviteteve dhe programeve të ndryshme, krahas mbrojtjes së të drejtave të burgosurve, ka dhënë kontribut në rehabilitimin dhe risocializimin e personave që kanë rënë ndesh me ligjin për ri integrim të suksesshëm në shoqëri.*

*Shërbimi Korrektues i Kosovës është vlerësuar me Çmimin Ndërkombëtar të Ekselencës nga Organizata Ndërkombëtare e Burgjeve dhe Shërbimeve Korrektuese (ICPA), për projektin “Rehabilitimi Gjithëpërfshirës dhe Kujdesi Shëndetësor”. Ky vlerësim prestigjioz iu nda gjatë Forumit të Shefave të Shërbimeve të ICPA-së, i cili është mbajtur në muajin tetor 2025 në Stamboll, Turqi, në kuadër të Konferencës së 27-të Vjetore të kësaj organizate ndërkombëtare.*

*Falënderoj stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës për punën e pa lodhshme në vazhdimësi për përmbushjen e misionit tonë të përbashkët.*

*Falënderoj po ashtu për mbështetjen e pa kursyer Kabinetin e MD-së, Ambasadën Amerikane në Republikën e Kosovës, Misionin e Eulex-it në Kosovë, Misionin e OSBE-së, Këshillin e Evropës, Mediat në Republikën e Kosovës si dhe të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare që në vazhdimësi kanë mbështetur Shërbimin Korrektues të Kosovës.*

*Si SHKK jemi çdo herë të hapur për bashkëpunim me të gjithë duke synuar kështu që të përmbushin plotësisht misionin tonë për risocializim dhe ri integrim të personave të privuar nga liria si dhe duke ofruar siguri për gjithë shoqërinë.*

# I. PJESA E PARË

## MISIONI

Misioni i Shërbimi Korrektues i Kosovës është të siguroj prezencën dhe mirëqenien e personave të privuar nga liria të cilët mbahen në Institucionet Korrektuese, të korrektoj dhe ri socializoj të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa diskriminim si dhe përgatitjen e tyre për jetë në liri si persona të dobishëm për rrethin shoqëror në përgjithësi.

## VIZIONI

Të promovojë një shoqëri të drejtë dhe të sigurt nëpërmjet menaxhimit efikas dhe efektiv të shkelësve dhe administrimit të drejtësisë.

## STATUSI

SHKK është Agjenci Ekzekutive e Sigurisë cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe ka shenjë identifikuese, uniformën, flamurin dhe emblemën.

## FUSHËVEPRIMI SIPAS LIGJIT:

- Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burgim në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - Organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e burgimit të miturve dhe masave edukuese në IK përveç nëse Kodi i Drejtësisë për të Mitur e parasheh ndryshe Zbatimin e masës së paraburgimit sipas Kodit të Procedurës Penale;
  - Ndërmarrjen e masave të sigurisë për të ofruar ambient të sigurt dhe të përshtatshëm për jetë dhe punë;
  - Ndërmarrjen veprimeve për ruajtjen e rendit, disiplinës dhe mbrojtjes së pronës në institucionet korrektuese të SHKK-së;
  - Vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për trajtimin e të burgosurve;
  - Planifikimin, organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e programeve që i kontribuojnë risocializimit të burgosurve;
  - Nxitjen, motivimin dhe zhvillimin e aftësive dhe shkathtësive punuese për të burgosur;
  - Zhvillimin e aktivitetit ekonomik dhe krijimin e të ardhurave përmes njësisë ekonomike të SHKK-së;
  - Motivimin dhe krijimin e mundësive për arsimim dhe aftësim profesional për të burgosurit;
  - Zhvillimin profesional të personelit të SHKK-së;
  - Realizimin e bashkëpunimit me institucionet përkatëse dhe organizatat të cilat merren me çështjen e monitorimit e të drejtave të burgosurve;
  - Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar lidhur me planin e ri integritetit pas lirimit;
- Përbushjen e obligimeve tjera sipas legjislacionit në fuqi.

## II. PJESA E DYTË

### TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies, Shërbimi Korrektues i Kosovës ka vazhduar të përkushtohet në ngritjen e standardeve për informimin publik, forcimin e bashkëpunimit me publikun si dhe ndërtimin e një komunikimi të qëndrueshëm me mediat elektronike dhe të shkruara.

Transparenca, si një prej shtyllave kryesore të punës së SHKK-së, përbën jo vetëm një obligim për të ofruar informacion të saktë, por edhe për të garantuar qasje të lirë dhe të thjeshtë për të gjithë të interesuarit në informacionet që lidhen me punën dhe aktivitetet tona.

Gjatë vitit 2025, Divizioni për Komunikim me Publikun ka realizuar një sërë aktivitetesh për të përmbushur këtë mision:

- **Përgjigje ndaj kërkesave të mediave:** Janë trajtuar gjithsej **87 kërkesa** për informacione nga mediat.
- **Qasje në dokumente publike:** Janë pranuar **4 kërkesa për qasje** në dokumente publike, prej të cilave **4 janë miratuar**, duke respektuar legjislacionin në fuqi.
- **Storie televizive:** Me aprovimin e menaxhmentit të SHKK-së, janë realizuar **25 storie televizive** në institucionet korrektuese, duke pasqyruar nga afër punën, të arriturat dhe sfidat e institucioneve.
- **Komunikata për media:** Janë përgatitur dhe publikuar **208 komunikata** zyrtare për media dhe **4 videospote** promovuese, të cilat janë shpërndarë në mënyrë të rregullt përmes uebfaqes dhe rrjeteve sociale të SHKK-së.
- **Dokumentar për 26-vjetorin e SHKK-së:** Në shënimin e 26-vjetorit të themelimit, SHKK-ja ka përgatitur dhe publikuar një dokumentar që pasqyron zhvillimin dhe të arriturat e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

## Historike: Shërbimi Korrektues i Kosovës fiton Çmimin Ndërkombëtar të Ekselencës nga ICPA

Shërbimi Korrektues i Kosovës është vlerësuar me Çmimin Ndërkombëtar të Ekselencës nga Organizata Ndërkombëtare e Burgjeve dhe Shërbimeve Korrektuese (ICPA), për projektin “Rehabilitimi Gjithëpërfshirës dhe Kujdesi Shëndetësor”. Ky vlerësim prestigjioz është ndarë gjatë Forumit të Shefave të Shërbimeve të ICPA-së, i cili është mbajtur gjatë muajit tetor 2025 në Stamboll, Turqi, në kuadër të Konferencës së 27-të vjetore të kësaj organizate ndërkombëtare.

Çmimin e ka pranuar Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani, i cili në emër të institucionit ka falënderuar organizatën ICPA për këtë vlerësim të lartë ndërkombëtar dhe ka theksuar se ky sukses është rezultat i punës së përbashkët, profesionalizmit dhe përkushtimit të të gjithë stafit të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



## Departamenti i Shtetit i SHBA-së vlerëson sukseset e Shërbimit Korrektues të Kosovës

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, në vitin 2025 ka zhvilluar takim me Kyle Conahan, zyrtar i Departamentit të Shtetit të SHBA-së nga Zyra për Kundërterrorizëm.

z. Kyle Conahan u informua për zhvillimet, të arriturat dhe sukseset e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si në nivelin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtare, me theks të veçantë në rolin dhe avancimin e Njesisë së Inteligjencës së SHKK-së.

Palët diskutuan edhe për çështjet që lidhen me kundërterrorizmin, bashkëpunimin ndërinstitucional dhe forcimin e sigurisë.



## Trajnimi profesional për zyrtarët korrektues në Mbretërinë e Danimarkës

Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ridvan Hoti dhe Kryeinspektori, z. Muamer Bikliqi kanë marrë pjesë në ceremoninë e certifikimit të 15 zyrtarëve korrektues të Kosovës, e cila u zhvillua në Kopenhagë.

Në ceremoni ishin të pranishëm Ministri i Drejtësisë i Danimarkës, z. Peter Hummelgaard, Drejtresha e Shërbimit Danez të Burgjeve, znj. Ina Eliassen, si dhe përfaqësues institucionalë nga të dy vendet. Gjatë fjalës së tij, z. Hoti theksoi se kjo ceremoni shënon suksesin e një grupi profesionistësh korrektues nga Kosova, të cilët me përkushtim dhe seriozitet kanë përfunduar një trajnim të avancuar në Danimarkë. Ai e vlerësoi këtë përvojë si një mundësi të rëndësishme profesionale dhe njerëzore, e ndërtuar mbi vlerat e respektit, përgjegjësisë dhe profesionalizmit.



## Shërbimi Korrektues i Kosovës merr pjesë në takimin e Këshillit të Evropës në Strasburg

Me ftesë të Këshillit të Evropës, Shërbimi Korrektues i Kosovës mori pjesë dhe prezantoi praktikat institucionale, në takimin shumëpalësh me temë “Forcimi i Politikave dhe Praktikave të Ndjeshme ndaj Gjinisë në Burgjet e Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës”, i cili u mbajt në Strasburg më 12 dhe 13 nëntor 2025.



### Vizita e Komisionit për Ligjet e Finlandës

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani, së bashku me Drejtorin e Burgut të Sigurisë së Lartë, z. Rasim Selmani, ka pritur në takim delegacionin e Komisionit për Ligjet të Finlandës, të kryesuar nga z. Juho Eerola, Kryetar i Komisionit, si dhe deputetë të tjerë të Parlamentit të Finlandës. Delegacioni finlandez u njoftua për prioritetet strategjike të Shërbimit Korrektues të Kosovës, përfshirë avancimin e kushteve të trajtimit të personave të privuar nga liria, forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit korrektues dhe përmirësimin e infrastrukturës në institucionet korrektuese.

### Kosova për herë të parë merr pjesë në Konferencën Vjetore të EuroPris-it – SHKK prezanton arritjet dhe sfidat

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani, së bashku me Zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm, z. Ridvan Hoti, kanë marrë pjesë në konferencën vjetore të drejtorëve të burgjeve, të organizuar nga EuroPris, e cila këtë vit po mbahet në Krakov të Polonisë.

Kjo konferencë, e cila mbledh çdo vit drejtuesit më të lartë të institucioneve korrektuese nga vendet anëtare të EuroPris-it, shënon një moment historik për Kosovën, pasi për herë të parë po përfaqësohet si vend i barabartë dhe si anëtar i ri i kësaj organizate evropiane.



## Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së ka takuar Presidentin e CPT-së

Gjatë qëndrimit në Krakov të Polonisë Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës z. Ismail Dibrani ka zhvilluar një takim të rëndësishëm me Presidentin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Çnjerëzor (CPT) z. Alan Mitchell. Në takim u prezantuan arritjet e deritashme të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke theksuar angazhimin e institucionit për respektimin e standardeve evropiane në trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve.



## Vizita e Shefit të EULEX-it

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani, së bashku me Drejtorin e Qendrës Korrektuese të Dubravës, z. Sami Gashi, pritën në takim Shefin e Misionit EULEX, z. Giovanni Pietro Barbano. Gjatë takimit u diskutua për të arriturat e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe për fushat e bashkëpunimit të mëtejshme ndërmjet dy institucioneve. Z. Barbano përgëzoi angazhimin dhe punën e bërë në Qendrën Korrektuese të Dubravës, duke vlerësuar përkushtimin e stafit dhe përmirësimet e vazhdueshme në këtë institucion korrektues.



## **Komandanti i KFOR-it Enrico Barduani pritet në takim në Drejtorinë e Përgjithshme të SHKK-së**

Drejtori i Përgjithshëm z. Ismail Dibrani, priti në takim Komandantin e misionit të KFOR-it të udhëhequr nga NATO, gjeneralmajor Enrico Barduani. Takimi ishte pjesë e angazhimeve të rregullta që Komandanti i KFOR-it mban me përfaqësuesit e institucioneve në Kosovë.

Ndërveprime të tilla kontribuojnë në mirëkuptimin e ndërsjellë dhe ndihmojnë në forcimin e marrëdhënieve të besueshme midis KFOR-it dhe homologëve të tij.



## **Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Gjykata Themelore në Prishtinë realizojnë për herë të parë seancë gjyqësore përmes videolidhjes**

Në koordinim të ngushtë mes Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, është mbajtur për herë të parë seanca gjyqësore përmes videolidhjes, duke shënuar kështu edhe një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të sistemit korrektues dhe gjyqësor.



## Shërbimi Korrektues i Kosovës pjesë e përpjekjeve rajonale për luftimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në burgje

Shërbimi Korrektues i Kosovës ka marrë pjesë aktive në Konferencën e 3-të Rajonale “Përshtypjet nga pilotimi i mjeteve dhe programeve specifike për VEP dhe rruga përpara në Ballkanin Perëndimor”, e mbajtur më 3-4 qershor 2025 në Budva të Malit të Zi. Konferenca kishte për qëllim shqyrtimin e përvojave dhe rezultateve nga zbatimi i pilot i mjeteve dhe programeve të specializuara për parandalimin e radikalizimit dhe rehabilitimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm në rajon.



## Shërbimi Korrektues i Kosovës pranon donacionin e radhës nga ICITAP

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani, së bashku me stafin drejtues, zhvilloi një takim me Këshilltarin Global të ICITAP-it për Kundërterrorizëm, z. Bill Sage, dhe Këshilltarin Rajonal për Njësitë e Inteligjencës Korrektuese, z. Frank Karam.

Mbështetja e ICITAP-it u vlerësua lartë nga drejtuesit e SHKK-së, veçanërisht për Departamentin e Inteligjencës Korrektuese të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Ky departament ka arritur të rrisë ndjeshëm nivelin e sigurisë, duke u shndërruar në një histori suksesi dhe një model të mirë për të gjithë rajonin.

Në kuadër të këtij takimi, u bë edhe dorëzimi i donacionit të radhës me pajisje të avancuara teknologjike, të cilat përfshijnë kompjuterë, pajisje detektuese dhe monitorë vëzhgimi, në vlerë prej rreth 50 mijë dollarësh.



## Vizitë në Danimarkë

Ministrja e Drejtësisë së Kosovës znj. Albulena Haxhiu, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës z. Ismail Dibrani, kanë takuar Ministrin danez të Drejtësisë, z. Peter Hummelgaard dhe Drejtoreshën e Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit Sprovues të Danimarkës, znj. Ina Eliassen ku u diskutua lidhur me zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës për dhënien në shfrytëzim të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan.

## Takimi me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës z. Ismail Dibrani është takuar me ambasadorin e Republikës së Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj me të cilin biseduan lidhur me sfidat dhe të arriturat e SHKK-së, si dhe për përpjekjet e vazhdueshme në fushën e korrektimit, risocializimit dhe rehabilitimit të personave të privuar nga liria. Ambasadori Malaj vlerësoi punën e SHKK-së dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes dy vendeve në këtë fushë, ndërsa u interesua edhe për trajtimin e shtetasve të Shqipërisë që po mbahen në institucionet korrektuese.

## Pjesëmarrja në konferencën më të rëndësishme të sistemit korrektues në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Me ftesë të Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, së bashku me zyrtarët korrektues të inteligjencës, kanë marrë pjesë në Konferencën Vjetore të Shoqatës Korrektuese Amerikane (ACA), e cila po zhvillohet në Orlando, Florida. Kjo konferencë, si një nga më të rëndësishmet në fushën e sistemit korrektues, ofron një platformë të shkëlqyer për shkëmbimin e përvojave dhe ideve midis drejtuesve të shërbimeve korrektuese nga Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera.



Përmes këtyre aktiviteteve Shërbimi Korrektues i Kosovës ka dëshmuar përkushtimin e tij për të qenë institucion transparent, i besueshëm dhe i afërt me publikun përmes mediave. Mbetemi të angazhuar për të vazhduar me përmirësimin e komunikimit dhe rritjen e bashkëpunimit me të gjitha palët e interesuara.

### III. PJESA E TRETË

#### Çështjet Ligjore

Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes Departamentit Ligjor ka siguruar ligjshmërinë e punës së institucioneve korrektuese në mënyrë që çdo aktivitet dhe vendimmarrje të jetë konform ligjit. Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë kësaj periudhe ka arritur të përmbush nevojat e rregullimit ligjor të fushëveprimit të saj duke eliminuar vështirësitë dhe zbrazëtirat ligjore për një funksionim efikas për të mundësuar realizimin e të drejtave të personave të privuar nga liria të cilët janë në mbajtje në institucione korrektuese.

Departamenti Ligjor në bazë të planit të punës ka ndërmarr veprime me qëllim të përmbushjes së obligimeve dhe kryerjes së detyrave me përgjegjësi dhe ka arritur që të jap mbështetjen e nevojshme ligjore për funksionimin efikas të SHKK-së dhe në këtë raport vjetor për vitin 2025 prezanton të arriturat.

**Hartimi i rregullave të brendshme** për funksionimin efikas të institucioneve korrektuese të miratuara gjatë vitit 2025 janë:

#### RREGULLAT E BRENDSHME TË MIRATUARA

- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Zyrtarët Korrektues;
- Udhëzuesi për Parashtrimin e Ankesave dhe Kërkesave të Burgosurve;
- Rregulla e Brendshme për Menaxhimin e të Burgosurve me Rrezikshmëri të Lartë dhe Shumë të Lartë;
- Rregulla e Brendshme Tretmanët për të Mitur;
- Rregull e Brendshme për Transferimin e Personave të Burgosur;
- Broshura informuese për të drejtat dhe obligimet e personave të burgosur;
- Hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të vendeve të punës së personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Performances për vitin 2026 për Shërbimin Korrektues të Kosovës
- Hartimi dhe miratimi i Planit të përditësuar të Integritetit për vitin 2026 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

#### Po ashtu janë përgatitur draftet për rregullat e brendshme

- Rregulla e brendshme Zhvillimi Profesional i Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës
- Rregulla e Brendshme për Pajisjen dhe Përdorimin e Armëve të Zjarrit

#### VIZITA NË INSTITUCIONET KORREKTUESE LIDHUR ME MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT:

Gjatë vitit janë realizuar vizita në institucionet korrektuese (Qendrën e paraburgimit Mitrovicë, Qendrën Korrektuese Smrekonicë, Burgun e Sigurisë së Lart, Qendrën e paraburgimit Prishtinë, Qendrën Korrektuese për të mitur dhe Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan) lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe janë përcjellë raportet me të gjeturat dhe rekomandimet.

Mbikëqyrja e rregullt dhe rekomandimet për përmirësim kanë ndikuar pozitivisht për të siguruar se veprimet bëhen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi dhe kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e efikasitetit të punës së institucioneve korrektuese, gjithashtu monitorimi është bërë edhe përmes shkresave dhe raporteve të ndryshme të hartuara nga Institucionet Korrektuese.

Departamenti Ligjor ka realizuar vizita në institucionet korrektuese për të verifikuar dhe krahasuar rastet e pranuar në institucionet korrektuese si recidivist.

#### **KËRKESAT PËR FALJEN E DËNIMIT:**

Gjithsej gjatë vitit 2025 kemi pranuar dhe përcjellë tek organet kompetente 65 kërkesa për faljen e dënimit nga të dënuarit.

Departamenti ligjor ka kontrolluar dhe kompletuar dokumentacionin sipas kërkesave për falje të burgosurve dhe në këtë mënyrë ka siguruar dhe lehtësuar qasjen e të burgosurve për adresimin e kërkesave në Zyrën e Presidencës për realizimin e të drejtës për falje. Kemi pranuar një Dekret për falje nga Presidenca e Republikës së Kosovës ku të dënuarës A.C i është falur pjesa e mbetur e dënimit.

#### **KËRKESA PËR PEZULLIM DËNIMIT:**

Gjatë vitit 2025 kemi pasur 09 kërkesa për pezullim dënimit për arsye të gjendjes jo të mirë shëndetësore. Pesë (5) kërkesa janë aprovuar, ndërsa tre (3) prej tyre janë refuzuar.

#### **KËRKESA PËR EKSTRADIM DHE TRANSFERIM:**

Gjatë vitit 2025 në Departamentin Ligjore të gjitha kërkesat e pranuar nga Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar lidhur me transferet dhe ekstradimet e të burgosurve janë adresuar dhe janë kthyer përgjigje brenda afateve të përcaktuara.

#### **Bashkëpunimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

Të gjitha kërkesat për informacion lidhur me personat e burgosur të pranuar nga Këshilli Gjyqësor janë shqyrtuar dhe janë kthyer përgjigje duke siguruar dokumentacionin relevant dhe me këtë është ndërtuar një klimë e mirë e bashkëpunimit. Gjithashtu janë realizuar edhe vizita zyrtare nga Departamenti Ligjor në gjykatat përkatëse.

#### **Mbështetja Ligjore**

Gjatë vitit 2025 janë dhënë rekomandime dhe opinione ligjore sipas kërkesave të institucioneve korrektuese dhe për Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Opinionet kanë qartësuar vendimmarrjen për çështjet të ndryshme dhe kanë siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi.

#### **Përgjigje në rekomandimet e raporteve të Avokatit të Popullit**

Institucionet Korrektuese janë monitoruar nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2025. Është pranuar raport me rekomandime për përmirësimin e kushteve në Qendrën e Paraburgimit Mitrovicë ndërsa janë kthyer përgjigje lidhur me zbatimin dhe përmbushjen e rekomandimeve, ndërsa në çështje të ndryshme janë dhënë informacione të vazhdueshme sipas kërkesave të Avokatit të Popullit.

Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë gjatë vitit 2025 ka inspektuar Institucionet Korrektuese në zbatimin e dispozitave ligjore të cilat ndërlidhet me ekzekutimin e sanksioneve penale dhe të drejtat e personave të burgosur. Inspektorati i MD në të gjitha çështje e inspektuara ka dhënë vlerësim pozitiv duke konstatuar se në përgjithësi janë zbatuar në mënyrë të duhur dispozitat ligjore dhe procedurat për realizimin e të drejtave të përcaktuara.

## **Bashkëpunimi me institucione dhe organizata jo qeveritare:**

- Bashkëpunimi me EULEX te cilët perveq monitorimit te punës së Sherbimit Korrektues të Kosovës, kanë ofruar mbështetje në hartimin e disa politikave te SHKK, dhe kanë ofruar trajnime profesionale për zyrtarët e SHKK, përfshi edhe nivelin menaxherial;
- Bashkëpunimi me Zyrën e Këshillit të Evropës, respektivisht projektin “*Përmirësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria*”, përmes te cilit janë organizuar trajnime për zyrtarët e SHKK, mbi trajtimin e të burgosurve sipas standardeve të Këshillit të Evropës, dhe poashtu kemi pasur mbështetje edhe në ekspertizën e tyre për hartimin e disa dokumenteve strategjike; si dhe mbështetje përmes projektit “*Rritja e bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor për menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje dhe parandalimin e radikalizmit të mëtejshëm pas lirit*”, përmes të cilit janë hartuar Udhëzimet dhe Mjeti për Vlerësimin e Shëndetit Mendor të të burgosurve ekstremistë të dhunshëm (VEP), të burgosurve të marginalizuar dhe të burgosurve të cenusshëm ndaj radikalizimit në Ballkanin Perëndimor, dhe për të njëjtat kanë trajnuar edhe zyrtarët për zbatim të tyre në praktikë. Poashtu, përmes këtij projekti, kemi bere rishikimin e Programit rehabilitues “Programi i Kosovës për Përgatitje për Lirim dhe Mbështetje pas Lirit të Burgosurve”;
- Bashkëpunimi me OSCE përmes të cilës SHKK është mbështetur në disa aktivitete me qëllim të fuqizimit te kapaciteteve profesionale të stafit, dhe mbështetje në hartimin e broshurave për të drejtat dhe detyrimet e personave të burgosur ne Kosovë;
- Marrëveshje bashkëpunimi për dhënien në shfrytëzim të një (1) kati të objektit në Aeroportin e Prishtinës ndërmjet Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Policisë së Kosovës.
- Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Korrektues dhe Terre des hommes Laussane në Kosove.
- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Korrektues dhe Kolegjit Publik Ndërkombëtar te Biznesit IBMC ne Mitrovice.
- Bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ku për herë të parë përmes procedurës së subvencionimit është realizuar pajisja me libra shkollor për të miturit në QKL;
- Bashkëpunim me Qendrat e Aftësisë Profesionale të Agjencisë së Punësimit në Pejë, Mitrovicë, Prishtinë dhe Ferizaj lidhur me zbatimin e trajnimeve profesionale si dhe certifikimin e kandidatëve;
- Bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit në Lipjan dhe Istog, mbi mbarëvajtjen e zhvillimit të procesit mësimor;
- Bashkëpunim me OJQ Monumenta në kuadër të projektit Art nga burgu /pikturim në pëlhurë për gratë e dënuara, punimet e të cilave janë ekspozuar në ekspozitë dhe të njëjtat kanë pasur mundësi të shiten;
- Marrëveshje bashkëpunimi me me Institutin për Edukim dhe Hulumtim “Nexus”, që ka për qëllim Zhvillimin e hulumtimeve profesionale në institucionet korrektuese dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale.

## **Raportimi lidhur me Planin e Performancës për vitin 2025**

Departamenti Ligjor ka hartuar raportet periodike lidhur me përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të parapara për vitin 2025 dhe ka raportuar të Njësia Përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të performancës.

## **Raportimi lidhur me Planin e Integritetit 2025**

Departamenti Ligjor ka hartuar raportet periodike lidhur me përmbushjen e objektivave dhe aktiviteteve të parapara për vitin 2025 dhe ka raportuar te Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

## **Strategjia zhvillimore 2023-2027 e Shërbimit Korrektues të Kosovës**

Hartimi i raporteve periodike për zbatimin e planit të veprimit të strategjisë.

## **Plani kombëtar zhvillimor 2025-2027**

Hartimi i raporteve periodike nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për zbatimin e planit kombëtar zhvillimor.

## **Strategjia shtetërore kundër narkotikeve 2024-2028**


Hartimi i raporteve periodike nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për zbatimin e planit të veprimit

## **Sinjalizimi në Shërbimin Korrektues të Kosovës**

Zyrtari përgjegjës për sinjalizim në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka pranuar dhe trajtuar gjatë vitit 2025 shtatëmbëdhjetë (17) raste të sinjalizimit.

## **Përgjigjet në padi:**

Gjatë vitit 2025 janë pranuar 150 kërkesa për përgjigje në padi për të cilat Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përgatitur përgjigje në padi dhe i ka adresuar brenda afatit në Avokaturën Shtetërore për përfaqësim në gjykatat kompetente, gjithashtu ju është përgjigjur edhe kërkesave të eksperteve financiar lidhur me kompensimin shtesave për rrezikshmëri dhe punë gjatë vikendeve.



## IV. PJESA E KATËRT

### Siguria


#### Pranimet e të burgosurve në institucionet korrektuese:

01.01.2025 – 31.12.2025

Sipas raportimeve nga institucionet korrektuese gjatë periudhës 01.01.2025 deri me 31.12.2025 janë pranuar gjithsejtë 3453 të burgosur nëpër institucionet korrektuese.

Prej tyre kanë qenë: 1310 të Dënuar (madhorë), 52 e Dënuar (Femër), 1856 të Paraburgosur (madhorë), 71 të Paraburgosura (Femra), 129 të Mitur të Paraburgosur, 06 e Paraburgosur e Mitur (Femër), 07 të Mitur të Dënuar, 22 të Mitur me Masë Edukative.

#### Diagrami i përgjithshëm i të burgosurve të pranuar në Institucionet korrektuese




## Lirimet e të burgosurve nga Institucionet Korrektuese

01.01.2025 - 31.12.2025

Sipas raportimeve nga institucionet korrektuese gjatë vitit 2025 janë liruar gjithsejtë 3458 të burgosur.

Prej tyre kanë qenë: 1534 të dënuar madhorë, 56 të dënuara (femra), 28 të mitur me masë edukative dhe 1651 të paraburgosur (madhorë), 49 të paraburgosura (Femra) dhe 125 të paraburgosur (të mitur), 08 të dënuar (të mitur), 07 e mitur e paraburgosur (Femra).

*Diagrami i përgjithshëm i të burgosurve të liruar nga institucionet korrektuese*



<i>Lirimet me kusht</i>	<i>Lirimet e parakohshme</i>
-339-	-237-

**Pushimet e të dënuarve jashtë institucioneve korrektuese**

**01.01.2025 deri 31.12.2025**

Gjithsejtë : **1539** pushime të rregullta të burgosurve sipas institucioneve korrektuese

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QP Prishtinë	QK Lipjan	QP Mitrovicë	QP Gjilan	QP Prizren	QP Pejë	QEK Lipjan	QKF Lipjan
519	78	484	45	59	19	07	20	06	273	29

**Tab: 1\*** Lista e vikendeve të dënuarve sipas institucioneve prej 01.01.2025 – 31.12.2025

Gjithsejtë : **34** pushime të jashtëzakonshme të burgosurve sipas institucioneve korrektuese

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë
20	01	13

**Tab: 2\*** Lista e vikendeve të Jashtëzakonshëm të dënuarve sipas institucioneve prej 01.01.2025 – 31.12.2025

Pushime të rregullta	Pushime të jashtëzakonshme	Totali i të Burgosurve në individ
-1539-	-34-	- 382-

**Transferimet ndër institucione korrektuese**

**01.01.2025-31.12.2025**

Gjatë vitit 2025 nga Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve (NJPB) dhe zyrtar tjerë korrektues janë realizuar **1177** transferime të burgosurve ndër institucionet korrektuese, të cilat në përgjithësi janë bërë për shkak të: mbarimit të periudhës së vlerësimit, trajtimit mjekësorë apo në interes të ruajtjes së rendit dhe sigurisë brenda institucioneve korrektuese. Daljet sipas institucioneve të paraqitura në tabelë:

Muaji	QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QK Lipjan	QP Prishtinë	QP Gjilan	QP Prizren	QP Pejë	QP Mitrovicë	Total
Janar	24	09	00	00	50	10	09	08	01	111
Shkurt	28	02	04	00	55	10	04	03	00	106
Mars	21	01	00	00	69	17	11	05	01	125
Prill	14	04	01	00	42	09	03	04	04	81
Maj	17	05	00	00	67	11	07	10	01	118
Qershor	04	08	00	00	54	11	01	05	03	86
Korrik	13	09	01	00	50	17	07	07	05	109
Gusht	09	07	00	00	56	11	01	04	02	90
Shtator	15	02	00	00	49	07	00	03	06	82
Tetor	13	12	00	00	72	07	00	04	07	115
Nëntor	05	05	01	00	44	10	03	06	06	80
Dhjetor	06	02	00	00	49	03	01	05	08	74
<b>Totali</b>	169	66	07	00	657	123	47	64	44	1177

**Kontrabanda**  
**01.01.2025 - 31.12.2025**

**Statistika e gjetjeve dhe parandalimit të kontrabandës në sasi në institucionet korrektuese**

Gjatë vitit **2025** në institucionet korrektuese janë evidentuar **176** bastisje pozitive prej të cilave **126** raste kanë qenë **gjetje** e kontrabandës dhe **50** raste tjetër kanë qenë bastisje **parandaluese**.

***Tabela e gjetjes së Kontrabandës 126 ( 71.59% )***

QK Dubravë	BSL	QK Lipjan	QEK Lipjan	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Pejë	QP Gjilan	QP Mitrovicë	QKF Lipjan	Total
<b>86</b>	<b>08</b>	<b>04</b>	<b>03</b>	<b>09</b>	<b>06</b>	<b>01</b>	<b>02</b>	<b>04</b>	<b>03</b>	<b>126</b>

***Tabela e Parandalimit të Kontrabandës 50 ( 28.41% )***

QK Dubravë	BSL	QK Lipjan	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Gjilan	QP Mitrovicë	QKF Lipjan	Total
<b>29</b>	<b>04</b>	<b>01</b>	<b>06</b>	<b>02</b>	<b>05</b>	<b>02</b>	<b>01</b>	<b>50</b>

***Bastisjet pozitive parandaluese sipas institucioneve për vitin 2025***

INSTITUCIONI	Telefon	Adapter/ose kablo	Sim kartelë	Narkotik	Usb-sd	Monedha/Raste	Stimulus	Kufje	Municion (Fishekë)	Brisk
QK Dubravë	23	23	09	17		05	01	02	03	01
BSL			03		01					
QK Lipjan				01						
QP Prishtinë	03	03		01						01
QP Prizren				02						
QP Gjilan	01		01	04						
QKF Lipjan				01						
QP Mitrovicë	02	02		02						
<b>Totali -----&gt;</b>	<b>29</b>	<b>28</b>	<b>12</b>	<b>28</b>	<b>01</b>	<b>05</b>	<b>01</b>	<b>02</b>	<b>03</b>	<b>01</b>

**Tab; 5\* Bastisjet (gjetje) sipas institucioneve për Vitin 2025**

INSTITUCIONI	Telefon	Bateri tel/ pjes e tel.	Adapter/ ose kaballo	Sim kartelë	Narkotik	Bizë	Usb-sd	Kufje	Monedha /Raste	Medikam ente/raste	Mjetë për tatuazh	Parfium (Copa)	Çels i automjetit	Shufer metalike	Supliment e të
<b>QK Dubravë</b>	50	03	35	33	43	10	02	02	02	01		07	02		01
<b>BSL</b>	03		02	01	01	07	01				01				
<b>QK Lipjan</b>	01		01			03	01								
<b>QEK Lipjan</b>	02		02	01	01	01									
<b>QP Prishtinë</b>	05		06	04	02	04	03							01	
<b>QP Prizren</b>	06		02	02		01					03				
<b>QP Pejë</b>						01									
<b>QP Gjilan</b>						01			01	01					
<b>QKF Lipjan</b>	01		02												
<b>QP Mitrovicë</b>	02			02											
<b>Totali -----&gt;</b>	70	03	50	43	47	27	07	02	03	02	04	07	02	01	01

**Kontrabanda e parandaluar gjatë vitit 2025:**

Nr.	Lloji i kontrabandës	Institucioni	Data
1	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QP Prizren	17.01.2025
2	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QK Dubravë	16.02.2025
3	USB	BSL	19.02.2025
4	Sim Kartel	BSL	21.02.2025
5	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QP Gjilan	03.02.2025
6	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QP Gjilan	13.02.2025
7	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QKF Lipjan	03.02.2025
8	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QK Dubravë	13.03.2025
9	Lëndë e dyshuar narkotike ( 227 gram me mbështjellës)	QK Dubravë	27.03.2025
10	Brisk (4.5 cm tehu)	QK Dubravë	30.03.2025
11	Monedha ( 150 euro)	QK Dubravë	31.03.2025
12	Sim Kartel	BSL	17.03.2025
13	Sim Kartel	BSL	17.03.2025
14	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QK Lipjan	21.03.2025
15	Monedha ( 50 euro)	QK Dubravë	08.04.2025
16	Monedha ( 110 euro)	QK Dubravë	20.04.2025
17	Adapter	QK Dubravë	16.05.2025
18	Lëndë e dyshuar narkotike ( 5 gram me mbështjellës) 01 Adapter	QK Dubravë	27.05.2025

19	Brisk	QP Prishtinë	08.05.2025
20	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QP Prizren	19.05.2025
21	Monedha ( 455 euro)	QK Dubravë	08.06.2025
22	Lëndë e dyshuar narkotike (0.0 gram me mbështjellës)	QK Dubravë	08.06.2025
23	Lëndë e dyshuar narkotike (25 gram me mbështjellës)	QK Dubravë	30.06.2025
24	01 Telefon mobil	QP Prishtinë	09.06.2025
25	Lëndë e dyshuar narkotike ( 786 gram me mbështjellës) 01 Telefon mobil, 01 Sim kartel , 01 Adapter	QK Dubravë	10.07.2025
26	Lëndë e dyshuar narkotike (1gram me mbështjellës)	QK Dubravë	22.07.2025
27	Lëndë e dyshuar narkotike (98gram me mbështjellës), 05 Telefona mobil, 03 Sim kartela, 07 Adaptera	QK Dubravë	30.07.2025
28	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QP Prishtinë	03.07.2025
29	02 Telefon mobil,01 Sim kartel, 01 Adapter	QK Dubravë	09.08.2025
30	Monedha ( 460 euro)	QK Dubravë	25.08.2025
31	01 Adapter	QP Prishtinë	04.08.2025
32	01 Telefon, 01 Sim kartel	QP Gjilan	20.08.2025
33	01 Sim kartel	QK Dubravë	14.09.2025
34	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia) 03 Telefon mobil,04 Adaptera,stimulus seksual	QK Dubravë	17.09.2025
35	Lëndë e dyshuar narkotike (10 gram me mbështjellës) 04 Telefona, 04 Adapter, 02 Kufje	QK Dubravë	22.09.2025
36	01 Telefon mobil,01 Sim Kartel	QK Dubravë	28.09.2025
36	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia)	QP Gjilan	29.09.2025
37	03 fishek	QK Dubravë	01.10.2025
38	Lëndë e dyshuar narkotike (2gram me mbështjellës)	QK Dubravë	28.10.2025
39	Lëndë e dyshuar narkotike (0.0 gram me mbështjellës)	QP Gjilan	15.10.2025
40	Lëndë e dyshuar narkotike ( nuk dihet sasia) 01 Telefon mobil,01 Adapter,	QP Mitrovicë	21.10.2025
41	Lëndë e dyshuar narkotike (29.5gram me mbështjellës) 01 Telefon,01 Adapter	QP Mitrovicë	27.10.2025
42	Lëndë e dyshuar narkotike (2gram me mbështjellës)	QK Dubravë	14.11.2025
43	Lëndë e dyshuar narkotike (5gram me mbështjellës)	QK Dubravë	19.11.2025
44	Lëndë e dyshuar narkotike (78gram me mbështjellës) 04 Telefona mobil, 02 Adaptera,	QK Dubravë	24.11.2025
45	Lëndë e dyshuar narkotike (0.0 gram me mbështjellës)	QK Dubravë	28.11.2025
46	02 Adapter	IPFK	13.11.2025
47	Lëndë e dyshuar narkotike (0.0 gram me mbështjellës)	QK Dubravë	09.12.2025
48	02 Telefona mobil,02 Sim Kartel, 03 Adapter	QK Dubravë	21.12.2025
49	01 Telefon mobil	QK Dubravë	29.12.2025
50	02 Telefona mobil,01 Adapter	QP Prishtinë	08.12.2025

## Incidentet e raportuara nga Institucionet Korrektuese në numra

INSTITUCIONI	RRAHJE	SULUM NDAJ STARTIT	KËRCNIMI NDAJ STARTIT	SULUM NDAJ TË BURGOSURVE	VETELËNDIM	TENTIM VARIE	VETË LËNDIM AKSIDENTAL	KËRCNIMI NDAJ TË BURGOSURIT	DEMOLIM	ZIARRVËNJE	FJALOSIE	TENTIM ARRATISIE/LARGIM	LARGIM	Arratisje	VETEVARJE	VDEKJE NE QKUK/SPITALE	REFUZIM MBYLLJE	NGJITJE MBI QATË
QK DUBRAVË	44	02	04	03	39	04	01		02	01	01	01	01			01	01	02
BSL	08	02	01		12	03	03		01	01								
QK SMREKONICË							01				01							
QK LIPJAN	06			06	03							01						
QEK LIPJAN	05			01	05		04					02	03					
QP PRISHTINË	06			02	07	01	01			01		01			01	02	01	
QP PRIZREN	02				02		01				01							
QP PEJË	03		02	01	11	02	02		06		01							
QP GJILAN	02	02		01	05	03	02										01	
QP MITROVICË	02			01	10		01							01				
QKF LIPJAN	01	02	02	01	01	01		01				01						
<b>Totali</b>	<b>79</b>	<b>08</b>	<b>09</b>	<b>16</b>	<b>95</b>	<b>14</b>	<b>16</b>	<b>01</b>	<b>09</b>	<b>03</b>	<b>04</b>	<b>06</b>	<b>04</b>	<b>01</b>	<b>01</b>	<b>03</b>	<b>03</b>	<b>02</b>

### Incidentet në Institucionet Korrektuese gjatë Vitit 2025

#### Grevat e urisë

Brenda Vitit 2025 në grevë urie janë futur nëntëdhjetë e katër (94) të burgosur, arsyetimet e tyre ishin për pakënaqësi me vendimin e gjykatës, kërkesë për transferim apo pakënaqësi me tretmanin (regjimin) e caktuar.

*Grevat e urisë nga të burgosurit sipas institucioneve për Vitit 2025*


QK Dubravë	BSL	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Pejë	QP Gjilan	QP Mitrovicë
58	06	07	05	03	02	13

**Lëvizjet dhe përcjelljet e të burgosurve jashtë Institucioneve Korrektuese  
për vitin 2025**

Të burgosur	Gjykatë	Prokurori	Spitale	Transfere	Përcjelljet humanitare	Shkollim jashtë IK	Kategori RRL	Kategori RRSHL	Tjera	Totali
Janar	417	173	356	111	10	00	55	12	00	1067
Shkurt	446	157	286	106	10	00	33	12	00	1005
Mars	527	184	316	125	29	00	39	07	02	1183
Prill	457	180	319	81	11	00	43	09	15	1063
Maj	467	211	346	118	18	00	41	11	00	1160
Qershor	472	135	330	86	15	00	36	30	08	1046
Korrik	495	177	371	109	11	00	36	25	00	1163
Gusht	171	157	339	90	12	00	20	06	00	769
Shtator	472	185	352	82	17	00	31	13	00	1108
Tetor	564	171	338	115	20	00	46	19	00	1208
Nëntor	440	214	267	80	19	00	28	19	16	1036
Dhjetor	498	176	317	74	26	00	50	18	00	1091
<b>Totali</b>	<b>5426</b>	<b>2120</b>	<b>3937</b>	<b>1177</b>	<b>198</b>	<b>00</b>	<b>458</b>	<b>181</b>	<b>41</b>	<b>12899</b>

## Lëvizjet dhe përcjelljet e të burgosurve

Diagrami i përgjithshëm i lëvizjeve të të burgosurve jashtë institucioneve korrektuese



\* Diagrami i përcjelljeve të të burgosurve nga NJPB - stafi korrektues i IK

### Përcjelljet humanitare të burgosurve

Në përcjellje për arsye humanitare gjatë Vitit 2025 janë dërguar **198** të burgosur.

QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QK Lipjan	QP Mitrovicë	QP Prishtinë	QP Prizren	QP Gjilan	QP Pejë	QKF Lipjan
98	33	13	5	5	12	14	6	4	8

**Tab:** Përcjelljet humanitare në vitin 2025

## Instituti i Psikiatrisë Forenzike – IPFK

Në Institutin Psikiatrisë Forenzike (IPFK) në QKUK aktualisht janë nëntë (09) të burgosur të hospitalizuar për trajtim dhe ekzaminim ( meshkuj ). Në IPFK gjatë vitit 2025 janë bërë 87 trajtime psikiatrike, 60 kthime në institucione.

**Lëvizjet e të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese sipas raportimeve në Qendrën Operative – të ndara sipas Institucioneve Korrektuese**


Gjithsejtë 3937 lëvizje të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese

	QK Dubravë	BSL	QK Smrekonicë	QK Lipjan	QEK Lipjan	QP Prishtinë	QP Pejë	QP Prizren	QP Gjilan	QP Mitrovicë	QKF Lipjan	Totali
Janar	88	25	22	12	07	78	17	24	42	14	27	356
Shkurt	71	24	11	04	03	85	10	27	46	00	05	286
Mars	85	34	11	13	03	84	13	18	43	01	11	316
Prill	78	46	14	12	12	45	30	21	43	03	15	319
Maj	101	21	17	19	12	74	18	19	30	06	29	346
Qershor	88	27	11	14	15	54	23	25	53	02	18	330
Korrik	88	34	14	14	08	103	27	14	48	08	13	371
Gusht	70	45	18	12	04	81	20	08	68	03	10	339
Shtator	105	41	17	17	04	62	19	14	49	02	22	352
Tetor	70	33	04	31	01	64	24	21	61	13	16	338
Nëntor	52	33	26	15	04	53	15	09	37	05	18	267
Dhjetor	49	47	13	13	39	53	15	19	52	03	14	317
<b>Totali</b>	<b>945</b>	<b>410</b>	<b>178</b>	<b>176</b>	<b>112</b>	<b>836</b>	<b>231</b>	<b>219</b>	<b>572</b>	<b>60</b>	<b>198</b>	<b>3937</b>

***Numri i lëvizjeve të të burgosurve sipas Institucioneve***

*Diagrami i përgjithshëm i lëvizjeve të burgosurve në spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese*

## GJITHËSEJT LËVIZJET E TË BURGOSURVE: 3937



*\*Diagrami i lëvizjeve të të burgosurve nëpër spitale/klinika jashtë Institucioneve Korrektuese*

## Ekstradimet e të burgosurve

- Gjatë Vitit 2025 nga Institucionet Korrektuese të Republikës së Kosovës janë ekstraduar gjithsejtë: 19 të burgosurve,
- Ndërsa nga shtetet tjera te ekstraduar ne Republikën e Kosovës janë gjithsejtë -31- të burgosur.

### Lista e të burgosurve të Kategorizuar

INSTITUCIONI	Totali	Të dënuar	Të paraburgosur	RR.SH.L	RR.L
BSL	63	31	32	17	46
QK Dubravë	08	08	00	01	07
QP Prishtinë	06	00	06	02	04
QP Gjilan	08	01	07	03	05
QKF Lipjan	02	00	02	00	02
QP Pejë	02	00	02	00	02
QP Mitrovicë	02	01	01	01	01
QP Prizren	01	00	01	01	00
QK Lipjan	01	00	01	00	01
TOTAL	93	41	52	25	68

### Arratisjet

- Gjatë vitit 2025 në Institucionet Korrektuese kemi pasur një (01) rast Arratisjes.

## V. PJESA E PESTË

### Njësia e inteligjencës

Departamenti për Inteligjencë i Shërbimit Korrektues ka për qëllim mbledhjen dhe përpunimi i informacioneve që paraqesin rrezik për rendin dhe sigurinë në Institucionet Korrektuese.

Me ftesë të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Byrosë Kundër-Terrorizmit të Departamentit të Shtetit (ICITAP), tre zyrtarë të Njesisë së Inteligjencës Korrektuese (NJIK) së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues ishin pjesëmarrës në Konferencën e vitit 2025 të Shoqatës Korrektuese Amerikane, e cila është zhvilluar në Orlando, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Udhëheqësi i Njesisë së Inteligjencës Korrektuese së bashku me zyrtarin e Analizës ishin pjesëmarrës në Konferencën e organizuar nga SBUNKER mbështetur nga Ambasada Holandeze me temë: **Ekstremizmi i djathtë në Republikën e Kosovës.**

Udhëheqësi i Njesisë së Inteligjencës Korrektuese ishte pjesëmarrës në Konferencën e organizuar nga BIRN me temë: **Publikimi i draft - raportit lidhur me Ekstremizmin në Republikën e Kosovës.**

Zyrtarët e Inteligjencës Korrektuese ishin pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga ICITAP me temë: **“Përdorimi i pajisjes CELLENSE”,** dhuruar nga partneri ynë ICITAP.



Udhëheqësi i Njesisë së Inteligjencës Korrektuese së bashku me Mbikëqyrësin e Divizionit për Operativ në cilësinë e ligjëruesve kanë realizuar trajnimin përmes platformës online me zyrtar të lartë të burgjeve të Republikës së Shqipërisë ( ky trajnim është mbështetur dhe organizuar nga partneri ynë strategjik ICITAP).

Temat e trajnimit:

- 1. Roli dhe funksioni i Departamentit të Inteligjencës**
- 2. Bashkëpunimi me mekanizmat e Sigurisë në Republikën e Kosovës dhe të ndryshme.**

Me ftesë të ambasadës së SHBA në Kosovë, Udhëheqësi i Njesisë së Inteligjencës Korrektuese së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm dhe zv/ Drejtorin e Përgjithshëm ishin pjesëmarrës ne ceremoninë e shënimit të përvjetorit te pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Me ftesë të ambasadës Franceze në Kosovë, Udhëheqësi i Njesisë së Inteligjencës Korrektuese së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm ishin pjesëmarrës në ceremoninë e shënimit të përvjetorit te pavarësisë se Republikës se Francës.

Nga data 20.07.2025 deri më 25.07.2025 zyrtar i Analizës së NJIK ne mbështetje të ICITAP ishte pjesëmarrës në cilësinë e ligjëruesit në trajnimin bazik për “Analistë në Republikën e Shqipërisë”, trajnim ky i cili është realizuar në Tiranë. Në këtë trajnim në cilësinë e ligjëruesve ishin pjesëmarrës edhe Zyrtarja e larte e analizës për Luftën kundër Terrorizmit në Zyrat Qendrore të ICITAP,

Zyrtarët e NJIK kanë përfunduar me sukses trajnimin për veglën e vlerësimit TRAP-18 – (Protokoli i Vlerësimit të Radikalizmit të Terrorizmit), i cili ka për qëllim t’u mundësojë profesionistëve të sigurisë identifikimin, vlerësimin dhe prioritarizimin e individëve që mund të paraqesin rrezik për përfshirje në veprime terroriste.

Në këtë trajnim morën pjesë zyrtarë nga Njësia e Inteligjencës e Shërbimit Korrektues të Kosovës, Shërbimi Sprovues , AKI dhe Policia e Kosovës, duke shkëmbyer përvoja dhe duke avancuar aftësitë profesionale në fushën e sigurisë.

Aktiviteti u organizua nga ICITAP, si pjesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm për forcimin e kapaciteteve institucionale në parandalimin e radikalizmit dhe terrorizmit.

Udhëheqësi i Njesisë së Inteligjencës Korrektuese ka realizuar takime me përfaqësues të institucioneve të ndryshme ku janë trajtuar tema të rëndësishme si:

- **Ekstremizmi i dhunshëm në Institucionet Korrektuese.**
- **Grupet e kërcënimit të Sigurisë brenda Institucioneve Korrektuese**
- **Roli i mekanizmave referues në luftimin e Ekstremizmit në Republikën e Kosovës.**
- **Parandalimi i Ekstremizmit të Dhunshëm”.**



Gjithashtu zyrtar të Njesisë së Inteligjencës kanë realizuar takime me:

- Zyrtar të lart të Agjencia për Inteligjencë e Kosovës.
- Zyrtar të lartë nga Policia e Kosovës.
- Zyrtar të lart të AMIK. (Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit te Klasifikuar).
- Zyrtar të lart të EULEX.
- Këshilltar i lartë Rajonal nga ICITAP për Njësitë e Inteligjencës Korrektuese
- Zyrtar të lart të DKT (Drejtoria Kundër Terrorizmit ) e Policisë së Kosovës si dhe të pranishëm në takim ish-in dhe zyrtar të lart të KFOR Austriak.
- Drejtuesit e lart të Institucioneve Korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut që drejtohej nga Drejtori i Përgjithshëm z/ Aleksandar Pandov.
- Këshilltarin Global të ICITAP-it për Kundër terrorizëm, z. Bill Sage, dhe Këshilltarin Rajonal për Njësitë e Inteligjencës Korrektuese, z. Frank Karam, gjatë takimit janë diskutuar çështje që lidhen me sigurinë në institucionet korrektuese, si dhe u theksua vazhdimi i bashkëpunimit dhe mbështetjes për SHKK-në, mbështetja e ICITAP-it u vlerësua lartë nga drejtuesit e SHKK-së, veçanërisht për Departamentin e Inteligjencës Korrektuese, në kuadër të këtij takimi, u bë edhe dorëzimi i donacionit të radhës me pajisje të avancuara teknologjike, të cilat përfshijnë kompjuterë, pajisje detektuese dhe monitorë vëzhgimi, në vlerë prej rreth 50 mijë dollarësh.

Zyrtar të Njesisë së Inteligjencës ishin pjesëmarrës në punëtori të ndryshme si:

- Punëtorja “Vlerësimi i implementimit të Planit të Veprimit të Strategjisë për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizimit 2023 – 2028” OSCE dhe MPB ( Ministria e Punëve të Brendshme )
- **Punëtorin mbi format e ndryshme te ekstremizmit te dhunshëm**, e organizuar nga ATRC ne bashkëpunim me Ministrinë e Punëve te Brendshme, respektivisht divizionin për siguri ne kuadër te programit 'Resilient and Inclusive Community Program' i financuar nga GCERF,
- Seminarin dy ditor të organizuar nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës, me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ekspertizën e Institutit Mbretëror për Mendim Islamik “Aal al-Bayt” nga Jordania (RABIIT), të përqendruar në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (CVE). Me temë **“Qasjet ndaj luftimit të Ekstremizmit të Dhunshëm – Nga Ekstremizmi në Islam deri te Mjetet e Parandalim”**

**Totali i raporteve me vlerë inteligjente përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025**

Raportet e Përgjithshme	Raportet Pozitive	Në Pritje	Totali
<b>Totali</b>	<b>104</b>	<b>87</b>	<b>191</b>

## VI. PJESA E GJASHTË

### Trajtimi i të burgosurve

Pavarësisht përballjes me sfida të konsiderueshme dhe mungesës së resurseve njerëzore dhe atyre teknike, rritjes së kërkesave dhe kompleksitetit të nevojave në fushën e risocializimit dhe ri integrimit të burgosurve, viti 2025 ka shënuar një progres të dukshëm dhe një ndryshim pozitiv në aspektin e zbatimit të programeve rehabilituese në institucionet korrektuese. Gjatë këtij viti është evidentuar rritje e theksuar e numrit të personave të dënuar që kanë marrë pjesë në programet rehabilituese, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e trajtimit, forcimin e aftësive personale dhe sociale, si dhe në përgatitjen më të mirë të tyre për një ri integrim të qëndrueshëm në shoqëri pas lirisë.

Numri total i të burgosurve të përfshirë në këto programe është 481, çka përbën një tregues domethënës të avancimit të praktikave rehabilituese dhe angazhimit institucional në këtë drejtim.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e detajuara zbatimin e programeve rehabilituese në institucionet korrektuese gjatë vitit 2025.

Programi	Totali i pjesëmarrësve
1. "TOPS"	12
2. "Menaxhimi i Zemërimit"	311
3. "Biseda për Ndryshim"	34
4. "Dhuna në Familje"	10
5. "Shkathësitë Sociale"	56
6. Programi i Përgjithshëm Rehabilitues	12
7. "Vendimarrja Sociale"	20
8. Nga OJQ SIT - Programi "Y +"	26
<b>TOTAL</b>	<b>481</b>

#### ➤ Procesi arsimor

#### Viti Shkollor 2024/2025 - Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan

Janë regjistruar dhe mësimin kanë vijuar 33 (tridhjetë e tre) të mitur, ndërsa prej tyre 21 (njëzet e një) e kanë përfunduar këtë vit mësimor.

- Shkolla fillore klasa I-V – 2 (dy) të mitur;
- Shkolla e mesme e ulët klasa VI-IV - 5 (pesë) të mitur;
- Shkolla e mesme e lartë klasa IV-XII – 14 (katërmëdhjetë) të mitur;

#### Viti Shkollor 2025/2026 - Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan

Kanë filluar procesin mësimor 43 (dyzet e tre) të mitur mirëpo, për shkak të lëvizjeve, lirimeve gjysëmvetorin e parë e kanë përfunduar 31 (tridhjetë e një) të mitur.

- Shkolla fillore klasa I-V – 7 (shtatë) të mitur;
- Shkolla e mesme e ulët klasa VI-IV – 7 (shtatë) të mitur;
- Shkolla e mesme e lartë klasa IV-XII - 17 (shtatëmbëdhjetë) të mitur

## Viti Shkollor 2024/2025 – Qendra Korrektuese Dubravë

Në shkollën e mesme teknike “RUDINA” në Dubravë si paralele të ndara të SH.M.T Mithat Frashëri në Istog, mësimin në e kanë filluar 49 (dyzet e nëntë) nxënës, mirëpo për shkak të lëvizjeve (lirimeve/transfereve) këtë vit shkollor e kanë përfunduar 19 (nëntëmbëdhjetë) të burgosur në drejtimet e makinerisë (saldues-metalpunues, automekanik dhe instalues i klimatizimit dhe ujësjellësit).

- Klasa X **09 (nëntë)** të dënuar,
- Klasa XI **05 (pesë)** të dënuar,
- Klasa XII **05 (pesë)** të dënuar.

## Viti Shkollor 2025/2026 – Qendra Korrektuese Dubravë

Kanë filluar procesin mësimor 49 (dyzet e nëntë) nxënës por gjysëmvetorin e parë e kanë përfunduar 34 (tridhjetë e katër të dënuar).

- Klasa X **20 (njëzet)** të dënuar,
- Klasa XI **09 (nëntë)** të dënuar,
- Klasa XII **05 (pesë)** të dënuar (maturantë).

Në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan në kuadër të projektit “Qendra e Integruar Kompjuterike“, financuar nga Ambasada Amerikane dhe me mbikëqyrje nga KUSA (Kosovo United States Alumni) është kompletuar kabineti i informatikës me 14 kompjuterë si dhe janë zhvilluar aktivitete të ndryshme edukativo arsimore.

### ➤ Trajnimet për aftësim profesional

Trajnimet për aftësim profesional të personave të dënuar janë zbatuar në QKM Lipjan, QKF Lipjan, QK Dubravë, Q.P Mitrovicë dhe QK Smrekonicë.

Profili trajnimit	QKL/ QEK të miturit	QKFL femrat	QK Dubravë	QP Mitrovicë	QK Smrekonicë	QP Pejë	Gjithsej
Ujë instalim	0	0	16	0	0	0	16
Elektro instalim	06	0	0	0	0	0	06
Ndërtimtari	18	0	15	0	0	0	33
IT	06	09	0	0	0	0	15
Rrobaqepësi	0	06	0	1	0	0	7
Instalim i ngrohjes	05	0	0	0	0	0	05
Kuzhinieri	0	0	0	04	05	0	09
Axhustator/saldues	0	0	17	03	0	0	20
Zdruktëhtari	0	0	14	02	0	0	16
Ndihma e parë	16	00	00	0	0	10	36

	51	15	62	10	05	10	153
--	----	----	----	----	----	----	-----

Tabela mbi numrin e pjesëmarrjes në trajnime për aftësim profesional.

Muaji	Të punësuar brenda Institucionit	Të punësuar jashtë Institucionit	Gjithsej
Janar	595	39	634
Shkurt	600	37	637
Mars	626	46	672
Prill	614	46	660
Maj	615	47	662
Qershor	619	44	663
Korrik	595	49	642
Gusht	609	47	656
Shtator	657	42	699
Tetor	659	54	713
Nentor	664	53	717
Dhjetor	675	56	731
Mesatarja vjetore e punesimit	627	47	674

➤ **Punësimi i të burgosurve,**

Të burgosurit me qëllim të ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive të tyre profesionale, janë angazhuar në punë në fusha të ndryshme me qëllim të përgatitjes së tyre për jetë në liri.

**Ekspozita “Art nga Burgu” sjell zërin dhe shpresën e grave të burgosura përmes artit**

Në ambientet e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës është mbajtur ekspozita e dytë “Art nga Burgu”, një iniciativë që synon të fuqizojë gratë e burgosura përmes artit dhe t’u ofrojë atyre mundësi për vetëpërmirësim dhe mbështetje financiare pas lirimit. Kjo ekspozitë përfaqëson një hap konkret drejt riintegritimit social dhe uljes së recidivizmit, duke përdorur terapinë e artit si mjet rehabilitimi dhe fuqizimi personal.

Projekti “Art nga Burgu” zbatohet nga organizata joqeveritare Monumenta në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës. Në kuadër të kësaj ekspozite, u prezantuan mbi 30 vepra artistike të krijuara nga gratë e burgosura, të cilat janë ekspozuar për t’u shitur dhe për të ndihmuar financiarisht autoret e tyre.



## VII. PJESA E SHTATË


### Njësia për Vlerësim dhe Klasifikim të Burgosurve

Me qëllim të ofrimit të programeve adekuata të trajtimit gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe mbështetjes së rehabilitimit dhe ri integritimit pas lirimit, me synim parandalimin e përsëritjes së veprave penale, procesi i vlerësimit dhe klasifikimit të dënuarve, gjatë këtij viti janë vlerësuar 715 raste.

Gjithashtu, me qëllim të rritjes së efikasitetit të procesit të vlerësimit kjo Njësi ka angazhuar staf të saj edhe në Qendrën Korrektuese të Dubravës.

Të dhënat statistikore mbi rastet e trajtuara nga NJVKB:

Lloji i vlerësimit	Numri (raste)
Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave dhe Planifikimi i Dënimit	326
Vlerësimi dhe Klasifikimi i të Burgosurve dhe Planifikimi i Dënimit	389
<b>TOTALI</b>	<b>715</b>



## VIII. PJESA E TETË

### Shpenzimet e buxhetit - Shërbimi Korrektues i Kosovës

Shërbimi Korrektues i Kosovës 336 000 Ligji 08/L-332								
Nr.	Përshkrimi	Buxheti Fillestar /2025	Buxheti Aktual	Pjesmarrja në përqindje ( % ) sipas kategorive ekonomike në Buxhetin e përgjithshëm	Alokime	Zotime - Detyrime të hapura	Shpenzime	Shpenzime të shprehura në përqindje në krahasim me Buxhet
11	Paga dhe Mëditje	14,521,698.00	16,095,714.45		16,095,714.45	-	16,095,714.45	110.84%
13	Mallëra dhe Shërbime	5,950,619.40	7,090,822.12		7,090,822.12	412,190.86	6,678,860.26	112.24%
14	Komunali	969,769.00	969,769.00		969,769.00	6,047.26	963,673.20	99.37%
30	Kapitale	14,595,000.00	10,603,194.00		10,603,194.00	8,218,217.66	1,757,503.86	12.04%
20	Subvensione dhe Transfere							
38	Rezervat							
	<b>Buxheti i Përgjithshëm</b>	<b>36,037,086.40</b>	34,759,499.57		34,759,499.57	<b>8,636,455.78</b>	<b>25,495,751.77</b>	70.75%
Vrejtje:	Numri i Stafit sipas Buxhetit 1770							
		<b>ALOKIMI I PARË :16.01.2025</b>						
	Punuar nga:							
	Drenusha Fazliu							
	Udhëheqese për Raportim dhe Egzekutim të Buxhetit							
	Shërbimi Korrektues i Kosovës							
						Shtim I mjeteve per koeficionin 0.5 Korrik/07.07.2025	15,144,124.61	622,426.61
	340,290.00 jane transferu nga SHKK pages per ImL neni 9						1700	
							55	
							93,500.00	
							1,122,000.00	

## IX. PJESA E NËNTË

### Inxhinieringu

#### **PROJEKTET KAPITALE TË MENAXHUARA DHE MBIKËQYRURA,**

Shërbimi Korrektues, përmes mekanizmave të saj profesional ka realizuar projektet duke menaxhuara dhe mbikëqyrura punën nga afër në Institucionet Korrektuese gjatë vitit 2025:

1. Rregullimi i dyshemesë nëpër burgje- rregullimi me epox,
2. Renovimi i kulmit dhe punët tjera ndërtimore në Spitalin e QK Dubravë,
3. Furnizimi i termopompës dhe funksionalizimi i sistemit solar në Qendrën Edukuese për të Mitur në Lipjan,
4. Matja e rrufepritsëve dhe tokëzimit nëpër të gjitha institucionet e burgjeve,
5. Rregullimi i ndriçimit në perimetrin e jashtëm të burgjeve dhe zëvendësimi i poçeve me poçe eficient.
6. Furnizimi dhe montimi i frigodhomave,
7. Eliminimi i defekteve në sistemin e rrjetit të kanalizimit në Q.K.Dubravë,
8. Riparimi i këmbyesve për bojleret industrial në Q.K- Dubravë.

Gjatë vitit 2025 në dyshemetë e Institucioneve Korrektuese janë bërë Intervenime në këto qendra:

1. Burgu i Sigurisë së Lartë,
2. Qendra e Paraburgimit në Prizren,
3. Qendra e Paraburgimit në Prishtinë.

Gjendja e dyshemeve në Institucionet Korrektuese nuk është e mirë dhe në disa Institucione me ekipen e të burgosurve nga BSL kemi bërë disa intervenime.

Gjendja ekzistuese e dyshemeve në QP Prishtinë.



Gjendja pas intervenimit në QP Prishtinë:



Gjithashtu në QP Prishtinë është bërë intervenim edhe në renovimin e Banjove me të Burgosur:

Gjendja paraprake:



Gjendja pas Intervenimit:



Projekt tjetër i realizuar është: **Renovimi i kulmit dhe punët tjera ndërtimore në Spitalin e QK Dubravë**

Gjendja para intervenimit në kulmin e objektit ishte jo e mirë pasi që kishte rrjedhje të ujit dhe kishte dëmtime të hapësirave të brendshme:



Gjendja e kulmit pas intervenimit:



**Projekti: Rregullimi i ndriçimit në perimetrin e jashtëm të burgjeve dhe zëvendësimi i poçave me poça eficient.**

Me këtë projekt është rregullimi i defekteve në sistemit e ndriçimit në perimetrin e jashtëm të burgjeve si dhe janë vendosur tetë reflektor (katër në burgun e Dubravës dhe katër në BSL), përparësi e këtyre reflektorëve është se niveli i ndriçimit ka rreze më të madhe si dhe mundësi e tyre të lëvizin dhe ta fokusojnë ndriçimin në objektin e caktuar.



Projekt tjetër i projektuar dhe mbikëqyrur nga divizioni ynë është edhe: **Furnizimi i termopompës dhe funksionalizimi i sistemit solar në Qendrën Edukuese për të Mitur në Lipjan**

Gjendja në Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan nuk ishte e mirë sa i takon sistemit të nxemjes dhe këtë vit përpos që është bërë montimi i një pompe termike 16 kW të re janë riparuar edhe disa nga pompat tjera të cilat kanë qenë jashtë funksionit si dhe është bërë funksionalizmi i sistemit solar në QKM Lipjan.



Gjithashtu kemi mbikëqyrur edhe projektin: **Furnizimi dhe montimi i frigodhomave**

Ky projekt ka një rëndësi të veçantë pasi që në kuzhinën e Dubravës produktet ushqimore ruheshin në frigodhomat e vendosura në bodrumin e këtij objekti dhe për shkak të derdhjes së ujit në mënyrë të pakontrolluar për larjen e kazanëve të zierjes së ushqimit shkaktonte rrjedhje tek frigodhomat dhe tani një frigodhomë për ruajtjen e produkteve ushqimore është vendosur në katin e parë ku edhe do të vendosen këto produkte.

Gjithashtu një frigodhomë është vendosur edhe tek Ferma e pulave e cila do të shërbejë për ruajtjen e vezëve deri në shpërndarjen e tyre në Institucionet tjera.



Projekti: **Renovimi i brendshëm i bllokut 2 në Qendrën Korrektuese në Dubravë** ka pasur vështërsi në realizimin e punimeve për shkak të operatorit të papërgjegjshëm i cili gjatë gjithë kohës ka ngecur në realizimin e punimeve.

Projekti: **Riparimi i këmbyesve për bojleret industrial në Q.K Dubravë** nuk ka përfunduar pasi që operatori ekonomik ka pretenduar se ka për ti ndërruar vetëm disa gypa të këmbyesve kurse në pozicion ka qenë punimi i këmbyesve, dhe ky projekt bazuar në shkresat e operatorit ekonomik dhe menagjerit nuk do të realizohet.

## X. PJESA E DHJETË

### Teknologjia informative

Në Divizionin e Teknologjisë Informative të Shërbimit Korrektues të Kosovës gjate kësaj periudhe 12 mujore te vitit 2025 janë realizuar këto projekte dhe aktivitete:

#### Aktivitetet:

Nr	Projektet	Aktiviteti
1	Video Seancat Gjyqësore (Sistemi i Audio Inçizimit) për te Burgosurit ne mes te SHKK dhe KGJK	<ul style="list-style-type: none"><li>• Është finalizuar projekti në tere Institucionet Korrektuese dhe kanë filluar seancat me Gjykata dhe te burgosurit.</li><li>• Trajnimi i stafit teknik nga SHKK për sistemin.</li></ul>
2	Menaxhimi i bazave te te dhënave	<ul style="list-style-type: none"><li>• Menaxhimi i bazës së të dhënave SIMB.</li><li>• Ri-trajnimi i stafit në përdorim te SIMB data bazës</li><li>• Formimi i moduleve të reja.</li><li>• Ri ndërlidhja me ARC.</li><li>• Ndërrimi i infrastrukturës së bazës së të dhënave SIMB, RRD dhe trajnimeve për stafin e SHKK.</li><li>• Formimi i modulit të ri për regjimet ne SHKK.</li></ul>
3	Ndryshimi i sistemit operativ për shfrytëzuesit e SHKK	<ul style="list-style-type: none"><li>• Totali i kalimit ne Windows 11 per kete vit qenë mbi 300 raste.</li></ul>
4	Zgjerimi i komunikimit virtual TEAMS	<ul style="list-style-type: none"><li>• Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve shtesë kompjuterike për tërë Institucionet Korrektuese të SHKK-se, për komunikim virtual në mes të burgosurve dhe familjarëve të tyre.</li></ul>
5	Menaxhimi dhe zgjerimi i sub-Domenit te SHKK	<ul style="list-style-type: none"><li>• Formimi i shfrytëzuesve te ri dhe azhurnimi i i atyre aktual ne kete subdomen.</li><li>• Ndryshimi dhe azhurnimi i 700 rasteve per shfrytëzuesit aktual duke ju përshtatur kërkesave të ASHI per nje infrastrukture me te sigurt ne RKS.</li></ul>
6	e-Kantina (blerjet online per te burgosurit)	<ul style="list-style-type: none"><li>• Konfigurimi dhe instalimi i e-Kantinës për blerjet online për të burgosurit është bërë në të gjitha Institucionet Korrektuese dhe konfigurimi i 50 sistemeve ne lidhje me kete projekt.</li></ul>
7	Realizimi i kërkesave te shfrytëzuesve në SHKK dhe jashtë SHKK-së në asistime në TI.	<ul style="list-style-type: none"><li>• Intervenimet në formën fizike, distanca, komunikim me telefon dhe virtual për zgjidhjen e problemeve me TI në SHKK dhe jashtë SHKK ka qenë afër 8000 intervenime.</li></ul>

## XI. PJESA E NJËMBËDHJETË

### Monitorimin e kontratave

Divizioni për Monitorimin e Kontratave ka për mision monitorimin dhe ofrimin e mbështetjes në administrimin e kontratave të Agjencisë, në cilësinë e autoritetit kontraktues, në raport me menaxherët e kontratave dhe/ose operatorët ekonomikë, në përputhje me Ligjin përkatës për Prokurimin Publik.

Divizioni për Monitorimin e Kontratave gjatë tërë vitit ka bërë përkrahjen e menaxherëve të kontratave dhe menaxherëve të projekteve lidhur me menaxhimin e zbatimit të kontratave, si dhe vlerësimi i performancës së operatorëve ekonomikë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Duke përfshirë monitorimin e performancës, dorëzimin e dokumentacionit përkatës, përmbushjen e obligimeve financiare, realizimin e pagesave dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale para mbylljes së kontratës si dhe përditësimin e të dhënave në Platformën e-Prokurorimi. Ky raport vjetor paraqet aktivitetet e realizuara, kontratat e monitoruara dhe shpenzimet financiare të evidentuara gjatë vitit 2025.

- Kontratat për furnizime;
- Kontratat për shërbime;
- Kontratat për servisime dhe mirëmbajtje;
- Procesin e pranimit të mallrave dhe shërbimeve;
- Procesin e pagesave në përputhje me kushtet kontraktuale.

Të gjitha aktivitetet janë zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në kontrata. Gjatë vitit 2025 janë realizuar këto monitorime:

- Pranimit të mallit nga kontrata: Furnizim me artikuj ushqimorë-Kantinë-Prishtinë.
- Pranimit të artikujve nga kontratat: Furnizim me artikuj sportive, Furnizim me mish gjedhi , furnizim me mish Gjedhi.
- Pranimit të mallit nga kontrata : Furnizim me material higjenik.
- Pranimit të pajisjeve për Autolarje në QP Prishtinë,
- Pranimit të mallit nga kontratat: Furnizim me artikuj ushqimorë Llot.4., Llot.5., furnizim me mish gjedhi, furnizim me mish pule dhe llot.3, furnizim me pemë dhe perime në QK Dubravë.
- Panimin e bukës në Q.P Prishtinë, mishit të gjedhit dhe mishit të pulës,
- Pranimi i mallit në QP Mitrovicë për kontratat : Furnizim me artikuj ushqimor, llot.4, llot.5, furnizim me mish gjedhi, furnizim me mish pule, llot.3, furnizim me pemë dhe Perime.
- Pranimin e mallit në Burgun e Sigurisë së Lartë dhe Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan, Gjilan.
- Furnizim me artikuj ushqimorë Llot.3, Llot.4, Llot 5, Furnizim me mish gjedhi , furnizim me mish pule, Furnizim me pemë dhe Perime, Furnizim me patate, Serivisim i automjeteve për nevojat e MD-së, SHKK-së, furnizim me impute bujqësore dhe furnizim me ujë.
- Përgatitja e modelit të kërkesave për të gjitha kontrata,
- Monitorim në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.
- Monitorim në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Për gjetjet dhe mangësitë e evidentuara, institucionet përkatëse janë njoftuar përmes e mailit zyrtar.
- Monitorim në Institucionin “Burgu i Sigurisë së Lartë”, për të cilin është përgatitur dhe përcjellë raporti përkatës me konstatimet dhe rekomandimet përkatëse.

Gjatë vitit 2025, Divizioni për Monitorimin e Kontratave ka përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tij në funksion të sigurimit të zbatimit të drejtë dhe efikas të kontratave, duke kontribuar në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe disiplinës kontraktuale brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Monitorimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me njësitë përkatëse dhe operatorët ekonomikë kanë ndikuar në përmirësimin e procesit të administrimit të kontratave dhe në menaxhimin më efikas të mjeteve buxhetore.

**Tabela e Kontratave të Monitoruara**

Nr.	Përshkrimi i Kontratës
1	Furnizim me mish pule dhe produkte – Lot 2
2	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte – Lot 1
3	Furnizim me patate
4	Furnizim me artikuj ushqimorë – Lot 5
5	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit
6	Mirëmbajtje dhe instalim i kamerave të sigurisë
7	Furnizim me material shtypës dhe zyrtar
8	Furnizim me goma dimërore dhe verore
9	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve (MD)
10	Furnizim me derivate për automjete
11	Furnizim me inpute bujqësore
12	Blerja e makinave për qepje
13	Furnizim me material për rrobaqepësi
14	Furnizim me uniforma për staf korrektues
15	Servisimi i pajisjeve të klimatizimit (SHKK/MD)
16	Furnizim me ujë për institucionet korrektuese
17	Furnizim me kositëse bari
18	Furnizim me makina për larje automjetesh
19	Furnizim me material higjienik
20	Pajisje për hekurosje (QK Dubravë & BSL)
21	Furnizim me karburant – naftë
22	Furnizim dhe montim i dhomave frigoriferike
23	Shërbime veterinarë (QK Dubravë)
24	Furnizim me furrë buke dhe pajisje
25	Furnizim me pemë dhe perime
26	Furnizim me bukë dhe brumëra
27	Furnizim me material murator dhe sanitar
28	Mirëmbajtje e data bazës së SHKK-së
29	Mirëmbajtje dhe Servisimi i serverëve
30	Mirëmbajtje e fotokopjeve
31	Servisimi i automjeteve Nissan/Mercedes/Peugeot
32	Rregullimi i dyshemeve me epoksi
33	Furnizim me material elektrik
34	Furnizim dhe servisimi i gjeneratorëve
35	Furnizim me pajisje sportive për Institucionet Korrektuese
36	Furnizim me municion për Shërbimin Korrektues
37	Korrja e grurit në hapësirat e Institucioneve Korrektuese
38	Furnizim me dyshek, batanije dhe jastëk, anti-zjarr për Institucionet e SHKK
39	Mbushja e klimave me gas në Institucione Korrektuese

40	Sanimi i portave hyrës në QP Mitrovicë, QK Dubravë dhe laures në BSL
41	Shërbimet veterinerë për kafshë dhe shpezë në Q. K. Dubravë
42	Furnizim dhe instalim i ventilatorëve në fermën e pulave në Q.K.Dubravë
43	Furnizim me ushqim për qenë për Q.K.Dubravë
44	Furnizim me Detektor dhe dere statik
45	Furnizim me Skaner X Ray DV, për skanimin e te gjitha pakove
46	Furnizim me paisje të sigurisë për kontroll të trazirave për Institucionet Korrektuese
47	Rregullimi i makinës për prodhimin e qeseve të mbeturinave
48	Sigurimi Kasko për veturat e SHKK-së
49	Instalimi i sistemit të ujitjes për Njësi Ekonomike
50	Furnizimi dhe instalimi i sistemeve mbrojtëse XR nëpër institucionet e SHKK-së
51	Furnizim me material për punë dore – artizanale
52	Furnizim me tepison dhe perde për Qendrën Korrektuese për femra në Lipjan
53	Ndërtimi -Zgjerimi I Institutit të Psikiatrisë Forenzike
54	Riparimi i këmbusve për bojlerët industrial në QK-Dubravë
55	Furnizim i Term pompës dhe funksionalizimi Sistemit Solar në Qendrën Edukuese për të mitur në Lipjan
56	Eliminimi i defekteve në sistemin e rrjetit të kanalizimit në QK-Dubravë
57	Matja e rufepritësve dhe tokëzimit nëpër gjitha institucionete SHKK-së
58	Rregullimi i ndriçimit në Perimetrin e jashtëm të burgjeve dhe zevendesimi i poqave me poqa eficient
59	Renovimi i Kulmit dhe punët tjera ndërtimore në Spitalin e QK-Dubravë
60	Renovim i brendshëm i bbllokut 2 në QK-Dubravë

#### Trajnime-Grup Punues:

Divizioni për Monitorimin e Kontratave ka organizuar një punëtori me të gjithë menaxherët e kontratave (16.12.2025-18.12.2025) me temën „ Menaxhimi i kontratave të dala nga prokurimi, plani për menaxhimin e tyre dhe kontrollet e brendshme” pjesëmarrës në punëtori kanë qenë 33 zyrtar.

## XII. PJESA E DYMBËDHJETË

### Trajnimet profesionale për personelin e shërbimit korrektues

Divizioni për Zhvillim Profesional i SHKK-së, në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) Vushtrri ka organizuar trajnime të vazhdueshme sipas plan programit të trajnimeve duke zhvilluar vazhdimisht kapacitete profesionale, organizative dhe metodologjinë trajnuese.

Gjatë periudhës vjetore raportuese janë organizuar dhe mbajtur një mori trajnimesh të llojeve të ndryshme për të gjitha nivelet e zyrtarëve të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Tabela e trajnimeve të realizuara:

Nr.	Trajnimi	Numri i trajnimeve	Numri i Pjesëmarrësve	Vendi i Realizimit
1	Trajnim Profesional për Zyrtar Korrektues gjenerata 45 e SHKK-së	01	115	AKSP
2	Trajnimi “Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave për Recidivizëm”	02	20	AKSP
3	Trajnimi “Menaxhimi i Vijës së Parë	01	05	AKSP
4	Trajnimi „Programi për Aftësimin e Instrukturëve (PAI)”	01	05	Prishtinë
5	Trajnimi Puna me të burgosur me probleme të abuzimit me substanca	01	15	Hotel Emerald EULEX
6	Puna me të burgosur me nevoja të veçanta	01	14	Hotel Emerald EULEX
7	Trajnimi Intervistim Motivues	01	17	AKSP
8	Trajnimi “Sjellja me njerëz dhe Detyrat në vendin e Punës”	01	06	AKSP
9	Themelor për aftësim mbi përdorimin e Armës –“MP-5	03	35	QKD/AKSP
10	Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19	01	16	QKD/AKSP
11	Trajnimi “Ngasja Emergjente”	13	57	AKSP
12	Trajnimi Elementet Bazike të Menaxhimit	01	06	AKSP
13	Trajnimi Menaxhimi i Zemërimit	01	12	AKSP
14	Trajnim i programit Tops	01	14	QK.Lipjan
15	Menaxhimi i aksidenteve radiologjike dhe zbulimi i kontrabandës së materialeve radioaktive dhe bërthamore	01	02	AKSP
16	Trajnimin e Trajnerëve për Zhvillimin e Kurikulave,	01	01	OSCE

17	Trajnimi për përdorimin e pajisjes për detektimit "CELLSENSE	01	05	QP.Prishtinë
18	Trajnimin për Programin “Vendimmarrja Sociale	01	22	QK.Lipjan
19	Trajnimin për Trajner’ Protokolli i Stambollit	01	08	Trofta Istog KE
20	Trajnimi - Të drejtat e komuniteteve në Kosovë	01	03	IKAP
21	Trajnimin për legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar për të drejtat e njeriut	01	18	Hotel Emerald OSCE
22	Trajnimin mbi teknikat e hetimit dhe intervistimit	01	20	QK.Smrekonicë
23	Trajnimin Praktikat Standarde të Veprimit (PSV) të Departamentit Shëndetësor në Burgje (DShB)	01	05	Hotel Trofta Istog KE
24	Trajnimi “Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit”	01	02	AKSP
25	Trajnimi për Trajnerë – Instruktorë të Armëve të Zjarrit	01	01	AKSP
26	Trajnim një ditor për ricertifikimin e zyrtarëve korrektues për teknikat mbrojtëse, pajiset e sigurisë (përdorimi i tyre) dhe shkrimin e raporteve të incidenteve	03	51	QKD
		43	475	

Gjatë vitit 2025, janë mbajtur **43** trajnime dhe janë trajnuar gjithsej, **475** zyrtarë të SHKK-së.

## XIII. PJESA E TREMBËDHJETË

### Njësia ekonomike

Njësia Ekonomike zhvillon aktivitete ekonomike, prodhuese, ofron shërbime, punëson të burgosurit bazuar në planin individual të dënimit me qëllim të risocializimit dhe ri integritimit. Njësia ekonomike zhvillon aktivitete përmes impianteve si në vijim: 1. Agrokultura me nëndegët e saj; 2. Blegtoria me nëndegët e saj; 3. Pemëtaria; 4. Perimtaria; 5. Lavërtaria dhe kultivimi i kulturave bujqësore.



Njësia Ekonomike prodhon dhe përpunon produktet nga brumrat për nevojat e SHKK-së, produkte këto të cilat janë prodhuar nga të burgosurit të cilat janë konsumuar në kuzhinat e institucioneve korrektuese.



Në Qendrat e Trajnimeve Profesionale në profile të ndryshme janë kryer aktivitete shërbyese dhe prodhuese si përpunim i drurit, metalit, qeseve të plastike etj, përpunimi i të cilave ka kursyer në mënyrë të konsiderueshme buxhetin e SHKK-së. Këto shërbime janë realizuar për nevojat e Institucioneve Korrektuese



## XIV. PJESA E KATËRMBËDHJETË

### Prokurimi publik

Shërbimi Korrektues i Kosovës në planin e prokurimit për vitin 2025 ka paraparë gjithsej **43 aktivitete të prokurimit**, prej tyre:

- **23 aktivitete** për furnizime;
- **6 aktivitete** për shërbime;
- **14 aktivitete** për punë.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar gjithsej **58 procedura të prokurimit**, prej të cilave:

- **8 aktivitete** janë zhvilluar jashtë Planit të Prokurimit,
- **1 aktivitet** është në procedurë.

Në Planin e Prokurimit janë përfshirë edhe **tetë (8) aktivitete** të cilat janë zhvilluar nga **Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)**, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 15/67, me të cilin është miratuar lista e artikujve të përbashkët.


Nga AQP janë zhvilluar këto aktivitete të prokurimit, ku institucioni ynë është palë përbërëse e kontratave përkatëse:

- Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë;
- Furnizim me ujë dhe pije të ndryshme;
- Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit;
- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimorë;
- Furnizim me derivate të naftës;
- Furnizim me mish dhe produkte të mishit;
- Furnizim me letër për printim;
- Shërbime të fotokopjimit, printimit dhe skanimit me qira.

Në Organin Shqyrtues të Prokurimit janë në shqyrtim këto lëndë:

1. Furnizim me material higjienik;
2. Furnizim me gjenerator për Burgun e Sigurisë së Lartë;
3. Furnizim me uniforma taktike;
4. Instalimi i sistemit të kamerave të sigurisë.

Gjatë vitit 2025 janë nënshkruar gjithsej 55 kontrata.



## XV. PJESA E PESËMBËDHJETË

### Burimet njerëzore

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore gjatë vitit 2025 ka ushtruar autorizimet e saj në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në planin e personelit dhe dispozitat tjera përkatëse.

Me Ligjin për Buxhet të vitit 2025 SHKK ka pasur të aprovuar 1770 pozita me masë buxhetor 14,521,698.00 euro e cila është shpenzuar 100%.

Në muajin dhjetor 2025 në Shërbimin Korrektues ka qenë të punësuar **1660** zyrtar, prej tyre zyrtar korrektues kanë qenë **1382**, ndërsa zyrtar civil dhe staf mbështetës kanë qenë **278**.

Të rekrutuar por ende pa filluar punën janë **100 Kadet për Zyrtar Korrektues** kurse pozita të lira janë dhjetë (10).

#### Ndarja e personelit sipas gjinisë:

Femra të punësuar janë: **280**

Meshkuj të punësuar janë: **1380**

#### Ndarja sipas nacionaliteteve:

Të punësuar shqiptar janë: **1531**

Të punësuar minoritete janë: **129**

<b>PENSIONIMET E PARAKOHËSHME</b>	<b>7 të pensionuar</b>
-----------------------------------	------------------------

<b>DORËHEQJE</b>	<b>21 të punësuar</b>
------------------	-----------------------

<b>PENSIONIM</b>	<b>47 të pensionuar</b>
------------------	-------------------------

<b>KOMISIONI DISIPLINOR</b>	<b>58 raste të inicuar</b>
-----------------------------	----------------------------

<b>TRANSFERE</b>	<b>39 të punësuar</b>
------------------	-----------------------

<b>TE NDJERË</b>	<b>05 të punësuar</b>
------------------	-----------------------

<b>KOMISIONI I ANKESAVE</b>	<b>28 lëndë të shqyrtuara</b>
-----------------------------	-------------------------------

